

VENDIM
Nr.632, datë 29.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE TË PËRJASHTIMIT TË PAGESAVE CASH
PËR BLERJE MALLRASH DHE SHËRBIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kufiri i lejuar i blerjeve me para në dorë, (cash), deri në 10 për qind të totalit të blerjeve, për vitin 2007, llogaritet nga data 6.8.2007, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9767, datë 9.7.2007, deri më 31.12.2007.

Për vitet pasardhëse, ky kufi shtrihet gjatë të gjithë vitit fiskal, i cili përputhet me vitin kalendarik.

2. Përfshihen nga rregulli i përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, tatimpaguesit, që kryejnë blerje, me para në dorë, nga individë të përgjithshëm në organet tatimore dhe që ushtrojnë veprimtari ekonomike, në fushën:

a) e grumbullimit dhe të përgatitjes për riciklim të mbeturinave dhe mbetjeve, metalike e jometalike (letër, gomë, sende plastike, tekstile, qelq etj.);

b) e grumbullimit dhe të përpunimit të bimëve mjekësore;

c) e grumbullimit dhe të përpunimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkut.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha